



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYËSORË PRIVATË  
REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr. 102 Regj  
Nr. 53 Prot

Tiranë, më 09.01.2018

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

**Drejtuar:** Qendra Kombetare e Biznesit ✓  
**Adresa:** Tirane  
**Per d jeni:** ALIU ROAD HOUSE sh.p.k Nipt K83211201N  
**Adresa:** Lagjia “Beqir Dardha”, Pallati 41/6, Prane Pedagogjikes, Elbasan,  
**Per d jeni:** “Cosmesi Center” Sh.p.k Nipt J92228501W  
**Adresa:** Autostrada Tirane - Durres, Xhafzotaj, Prane mbi kalimit Fllake.

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 11626 Akti , date 19.12.2017, i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 102, Datë 27.12.2017 kërkesën e kreditorit “Cosmesi Center” Sh.p.k Nipt J92228501W ndaj debitorit ALIU ROAD HOUSE sh.p.k Nipt K83211201N, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 21468704, date 02.06.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 28526866, date 27.12.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 28526049, date 10.12.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 25348095, date 14.10.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 28526050, date 10.12.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 25348094, date 14.10.2015, Fatura tatimore e shitjes Nr. Serie 39555215, date 12.08.2016”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 671 Prot, Datë 27.12.2017, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr. 11626 Akti , date 19.12.2017, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori ALIU ROAD HOUSE sh.p.k Nipt K83211201N, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit ALIU ROAD HOUSE sh.p.k Nipt K83211201N, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore ALIU ROAD HOUSE sh.p.k Nipt K83211201N, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdheri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijani.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Resul ALUSHANI

